

21 shkurt

- E Diela e Parë e Kreshmës - E ORTHODHOKSISË



E Diela e Parë e Kreshmës së Madhe është Festa e Triumfit të Orthodhoksisë. Ajo është një festë historike, që përkujton kthimin e ikonave nëpër kisha në vitin 843, mbas fitores kundër herezisë ikonoklaste. Tema shpirtërore e kësaj të Diele është, para së gjithash, fitorja e Besës së Vërtetë: “Kjo është fitorja që e mundi botën: besimi ynë” (I Joani 5:4). Së dyti, ikonat e shenjtoreve dëshmojnë që njeriu “i krijuar sipas shëmbëllesës dhe ngjashmërisë së Perëndisë” (Gjeneza 1:26), bëhet i shenjtë dhe i ngjashëm me Perëndinë, nëpërmjet pastrimit të vetvetes, si imazhi i gjallë i Perëndisë.

Kur praktika e “Triumfit të Orthodhoksisë” u vendos për herë të parë të Dielën e Parë të Kreshmës së Madhe, më 843, që binte më 11 mars atë vit, kjo u bë pikërisht që të shënonte fundin e ndarjeve dhe kthimin e paqes në gjirin e Kishës. 120 vjet para kësaj date, të krishterët e Perandorisë Bizantine ishin thellësisht të ndarë nga kundërshtimet ikonoklaste. Përfundimisht, perandoresha Theodora i dha fund këtij konflikti me mbështetjen e patriarkut të asaj kohe, Metodit. Qëllimi i saj ishte t’i jepej fund konflikteve që po mbillnin përçarje, dhe të krishterët të bashkoheshin në unitetin e besës dhe dashurisë për njëri-tjetrin.

Ky afirmim i gëzuar përbën edhe përmbajtjen e teksteve liturgjike të kësaj të diele: “Ti na mblodhe në kungim zemrash dhe krijove unitetin tonë” (Kanuni i Mëngjesores),

“Gjymtyrët e ndara të Krishtit u sollën në unitet... Perëndia na dha paqen” (Triodi i Kreshmës).

Le të agjërojmë prej pasioneve

Në datën 15 shkurt, filloi Kreshma e Madhe e Pashkëve. Ajo është simboli i gjallë i tërë jetës së njeriut, jetë që do të përmbushet në ngjalljen e tij prej së vdekurish me Krishtin. Është një kohë për të rigjallëruar devotshmërinë: me lutje, agjërim e lëmosha. Është një kohë pendese, një rigjallërim real i mendjes, zemrës dhe veprave tona, sipas Krishtit dhe mësimeve të Tij. Është një kohë, para së gjithash, e kthimit tonë drejt porosive të mëdha, për të dashur Perëndinë dhe të afërmit.

Le ta fillojmë kreshmën me gëzim... le të agjërojmë prej pasioneve ashtu siç agjërojmë prej të ngrënit, të dëfrehemi në fjalët e mira të Frymës, që të mund të shikojmë pësimin e shenjtë të Krishtit Perëndisë tonë dhe Pashkën e tij të shenjtë, duke u gëzuar shpirtërisht.

(Himn i Mbrëmësorës)

Si të kreshmojmë në mënyrë të shenjtë?

- Të kreshmojmë jo vetëm nga ana ushqimore, por edhe të largohemi nga mëkatet. Pra, një kreshmë ushqimore dhe shpirtërore.

- T’i falim dhe t’i ndejmë ata që na kanë lënduar shpirtërisht.

- Ta shoqërojmë kreshmën me lutje dhe t’i kushtojmë më shumë kohë leximin të Ungjillit dhe librave të tjerë shpirtërorë.

- Ta shoqërojmë kreshmën me lëmoshë, pra të ndihmojmë atë që ka nevojë.

- Ta shoqërojmë kreshmën me përlësi, pendim. Rreziku më i madh në kreshmim është të krenohemi për përpjekjet tona dhe të gëzojmë të tjerët që nuk kreshmojnë.

- Të kuptojmë që kreshma nuk është fundi, por është një mënyrë për të arritur në fund. Nuk është qëllim, por mjet për arritjen e qëllimit.

- Të kreshmojmë në fshehtësi; dhe Perëndia që sheh se ç’bëhet në fshehtësi do të na shpërblejë hapur.

- Të kreshmojmë me gëzim dhe duke u përpjekur të kemi sa më shumë dashuri për Perëndinë dhe për çdo njeri.

- Kreshmo nga ana ushqimore dhe lartësohu nga ana shpirtërore.

Le të kreshmojmë një kreshmë të pëlqyer të Perëndia.

Le të “presim dëshirën tonë”, le të bëjmë dëshirën e Perëndisë, sepse vetëm kështu do të fitojmë përlësi dhe do të kemi një komunikim të pandërprerë me Perëndinë. Dhe kështu arrihet qëllimi i kreshmës:

Lartësimi i shpirtit të Perëndia. Dhe le të mos harrojmë që e gjithë jeta jonë është një kreshmë, një kreshmë nga ana shpirtërore, pra një largim nga mëkati.

Për Kreshmën e Pashkëve duhet të dimë:

- Si rregull, gjatë saj nuk hahet mish, peshk, bulmet, vezë.
- Peshk hahet vetëm më 25 mars, e kremtja e Ungjillëzimit dhe në të Dielën e Dafinave.

- Lejohet ngrënia e frutave të detit.

- Kur është e mundur, kreshma mbahet pa ngrënë vaj ditët e javës (ose të paktën të premteve dhe të mërkurave), ndërsa të shtunave dhe të dielave përdoret gjithmonë vaji (me përjashtim të së Shtunës së Madhe).

- Verë pihet vetëm të shtunave dhe të dielave.

- Kushdo që ka probleme shëndetësore apo të tjera, që nuk e lejojnë ta mbajë kreshmën, duhet të bisedojë me atin shpirtëror.

Kreshmimi në Shkrimet e Shenjta dhe jetët e shenjtorëve

Dhe kur të agjëroni, mos u tregoni të pikëlluar si hipokritët; sepse ata shfytyrohen për t'u treguar njerëzve se agjërojnë; në të vërtetë ju them se ata tashmë e kanë marrë shpërblimin e tyre. Kurse ti, kur të agjërosh, vajose kokën dhe laje fytyrën, me qëllim që të mos u tregosh njerëzve se ti agjëron, por Atit tënd në fshehtësi; dhe Ati yt, i cili shikon në fshehtësi, do ta japë shpërblimin publikisht (Matheu 6:16-18).

Ata thonë: "Pse kemi agjëruar, dhe Ti nuk e ke parë? Pse kemi hidhëruar shpirtrat tanë dhe Ti nuk e ke vënë re?"

Ja, ditën e agjërit tuaj ju bëni atë që ju pëlqen dhe i detyroni punëtorët tuaj të kryejnë një punë të rëndë. Ja, ju agjëroni për grindje dhe mosmarrëveshje... Duke agjëruar ashtu si bëni sot, nuk bëni që zëri juaj të dëgjohet lart...

Agjërimi që më pëlqen a nuk është vallë ky: të thyesh zinxhirët e ligësisë... t'i lësh të lirë të shtypurit... A nuk qëndron vallë në ndarjen e bukës sate me atë që ka uri, në sjelljen në shtëpinë tënde të të varfrit pa strehë, në të veshurit e atij që është lakuriq...

Atëherë drita jote do të shpërthejë si agimi dhe shërimi yt do të mbijë menjëherë, drejtësia jote do të të pararendë dhe lavdia e Zotit do të jetë praparoja jote. Atëherë do të thërrasësh dhe Zoti do të të përgjigjet, do të bërtasësh dhe ai do të thotë: "Ja ku jam!" (Isaia 58:3-9).

...në agjërim nuk duhet vetëm bindje ndaj rregullit kundër grykësisë në lidhje me ushqimin, por frenim nga çdo mëkat, kështu që, ndërsa agjëron, gjuha të agjërojë gjithashtu, duke u frenuar nga shpifjet, gënjeshtat, të folurit keq, poshtërimi i vëllait, zemërimi dhe çdo mëkat i kryer nga gjuha. Një duhet të agjërojë, gjithashtu, nga sytë, domethënë, të mos shohë gjëra të kota... mos të shohë asnjë pa turp dhe pa ndrojtje. Duart dhe këmbët duhet të ruhen, gjithashtu, nga çdo veprim i keq.

Kur një agjëron nëpërmjet kotësisë ose mendimit që ai po kryen diçka veçanërisht të virtytshme, ai agjëron marrëzisht dhe shpejt fillon të kritikojë të tjerët dhe ta konsiderojë veten si të madh.

Një njeri që agjëron urtësisht... fiton pastërti dhe përulet... dhe e provon veten një ndërtues të aftë (Shën Ava Doritheu, shek 7, *Drejtime në Stërvitjen Shpirtërore*).

Bëhuni imituesit e mi, vëllezër, dhe vëreni ata që ecin kështu, sipas shembullit që keni në ne. Sepse shumë nga ata, për të cilët ju kam folur shpesh, edhe tani po jua them duke qarë, ecin si armiq të kryqit të Krishtit, dhe fundi i tyre është humbje, perëndia i tyre është barku dhe lavdia e tyre është në turp të tyre; ata mendojnë vetëm për gjërat tokësore (Filipianët 3:17-19).

Çdo gjë më lejohet, por jo gjithçka është e dobishme; çdo gjë më lejohet, por unë nuk do t'i nënshtrohem asnjëherë. Gjellët janë për barkun dhe barku për gjellët; por Perëndia do të shkatërrojë edhe këtë edhe atë; por trupi nuk është për kurvëri, po për Zotin, dhe Zoti për trupin (1 Korinthianët 6:12-13).

Ai që ha të mos e përbuzë atë që nuk ha, dhe ai që nuk ha të mos gjykojë atë që ha, sepse Perëndia e ka pranuar. Kush je ti që gjykon shërbyesin e tjetrit?

Ai që e çmon ditën, për Zotin e çmon; ai që nuk e çmon ditën, për Zotin nuk e ruan; kush ha, për Zotin ha dhe i falet nderit Perëndisë; dhe kush nuk ha, për Zotin nuk ha dhe i falet nderit Perëndisë.

Mos e bëj atë të humbasë me ushqimin tënd, atë për të cilin Krishti vdiq... sepse Mbretëria e Perëndisë nuk është të ngrënët dhe të pirët, por drejtësia, paqja dhe gëzimi në Frymën e Shenjtë. Sepse ai që i shërben Krishtit në këto gjëra, është i pëlqyer nga Perëndia dhe i miratuar nga njerëzit (shih Romanët 14).

Shërbesat gjatë periudhës së Kreshmës së Madhe

Shërbesat ditore gjatë Kreshmës së Madhe karakterizohen nga melodi të veçanta kreshmore të një karakteri pendimtar. Dyert e Bukura mbahen të mbyllyra, për të treguar ndarjen e njeriut prej Mbretërisë së Perëndisë nga shkaku i mëkatit. Veshjet e Kishës janë të errëta, zakonisht në ngjyrë vjollcë. Gjithashtu edhe troparet ditore kanë një karakter lutës, duke i kërkuar Perëndisë, me ndërmjetimet e shenjtorëve, të na mëshirojë ne mëkatarët.

Në Shërbesën e Mëngjesit **Ali-luiat** e gjata zëvendësojnë psalmin **Perëndia është Zoti...** Psalmodia është e zgjeruar. Himnologjia i referohet përpjekjeve kreshmore. Në Mbrëmësoret, kemi si shtesë lexime të Shkrimit të Shenjtë prej **Gjenezës dhe Fjalëve të Urta** dhe në Shërbesën e Orës së Gjashtë prej **Profetit Isaia**. Këndimet e Apostullit dhe Ungjillit nuk bëhen, meqenëse nuk bëhen Meshja Hyjnore.

Gjatë gjithë Kreshmës, në të gjitha shërbesat thuhet **Lutja e Shën Efrem Sirianit**. Në këtë lutje i kërkohe Perëndisë veçanërisht ato virtyte, të cilat janë të nevojshme për jetën e krishterë.

Zot dhe Mjeshtër i jetës sime, mos më jep frymë përtese, kuresh-tjeje, lavdidashjeje dhe kotësie.

Po falmë frymë urtësie, përlësie, durimi dhe dashurie.

Vlerësomë, o Zot dhe Mbret, t'i shoh fajet e mia dhe të mos e gjykoj tim vëlla. Se i bekuar je në jetë të jetëve. Amin.

Shërbesa e Mbrëmësore që fillon periudhën e Kreshmës, quhet **Mbrëmësorja e Faljes**. Të krishterët në këtë shërbesë, i kërkojnë falje njëri-tjetrit për çdo faj të bërë me dashje apo pa dashje.

Në shërbesat e Paskadës të javës së parë të kreshmës këndohet **Kanoni i Shën Andreas së Kretës**. Ky përbëhet nga disa seri vargjesh pendimtare, të bazuara në temat biblike. Secilit varg populli i përgjigjet: **Mëshiomë, o Perëndi, mëshiomë**. Ky kanon përsëritet në Mëngjesoren e së Enjtes të Javës së Pestë. Gjatë pesë javëve të para të kreshmës, të premtën në mbrëmje këndohet **Himni Akathist**, në nderim të **Hyjlindëses**.

E Shtuna e Parë e Kreshmës së Madhe i kushtohet kujtimit të Shën Theodor Tironit. E dyta, e treta dhe e katërta quhen **Të Shtunat e Shpirtrave**, meqenëse i janë kushtuar kujtimit të të vdekurve. Liturgjia Hyjnore e të Shtunës së Pestë bëhet për nderim të Hyjlindëses.

Gjatë të Shtunave të Shpirtrave himnet liturgjike luten universalisht për gjithë të fjeturit dhe gjatë Mën-

gjesoreve për të vdekurit, të quajtura **parastasis ose panikida**, të vdekurit përmenden me emra. Në Liturgjinë Hyjnore janë shtuar litani dhe lutje dhe këndimet nga Shkrimi i Shenjtë iu referohen të vdekurve dhe shpëtimit të tyre prej Krishtit.

Dita e shtunë, edhe gjatë periudhës jokreshmore, është dita për kujtimin e të vdekurve. Kjo, sepse e Shtuna, Dita e Sabatit, është dita kur Perëndia bekoj për jetën në këtë botë. Por, për shkak të mëkatit, kjo ditë tani simbolizon të gjithë jetën tokësore, të përmbushur natyrisht në vdekjen. Madje edhe Krishti, Zoti, u shtri i vdekur në Ditën e Sabatit, "duke pushuar nga të gjitha veprat e tij" dhe "duke shkelur vdekjen me vdekje". Kështu, në Kishën e Krishtit të Dhia-tës së Re, e Shtuna u bë dita për kujtimin e të vdekurve dhe për t'u lutur për shpëtimin e tyre të përjetshëm.

Urime për Kryepiskopin Anastas nga Primatë orthodhoksë

Fortlunturi,

Festimet e hirshme të sotme të ditës së emrit të Fortlunturisë Suaj fort të shtrenjtë dhe të dashur për ne, na japin rastin e bekuar t'Ju drejtojmë nga thellësia e zemrës përshëndetjet tona shumë të ngrohta plot përgëzim e urim: Qofshin vitet Tuaja, Fortlunturi dhe Vëlla i nderuar, të shumta dhe plot shëndet njëkohësisht, që të vazhdoni të drejtoni me aftësi timonin e Kishës Suaj të shenjtë për një kohë të gjatë, në harmoni dhe në të njëjtën frymë me anëtarët e Hierarkisë së nderuar dhe fort të shtrenjtë për Ju, për të mirën e grigjës së thirrur nga Krishti dhe për emrin e mirë të mbarë Kishës Orthodhokse.

Me këto urime, duke e rrethuar Fortlunturinë Tuaj të vyer me dashuri të shumtë vëllazërore dhe nderim të thellë, Ju puthim me puthje të shenjtë dhe kemi për Ju gjithmonë mall vëllazëror.

**Patriarku Ekumenik
†Vartholomeu I
Fanar 22.01.2010**

*Fortlunturia Juaj,
Bashkëvëlla dhe Bashkëmeshtar
i dashur më Zotin,*

Përzemërsisht Ju uroj me rastin e ditës së emrit.

E gjithë jeta juaj në mënyrë të pandërprerë ka qenë e lidhur me shërbimin ndaj Kishës së Shenjtë. Ashtu si shenjtori Anastas Persiani, ju e deshët Krishtin me gjithë zemër dhe me veprat tuaja sakrifikuese të përkushtuara jeni shembulli i bariut të mirë, që vë jetën e tij për dhentë (Jn. 10:11).

I lutem Zotit që t'ju dërgojë juve mirësi të begata dhe t'i japë Fortlunturisë Suaj paqe, shëndet për shumë vjet.

Me dashuri vëllazërore më Krishtin,

**Patriarku i Moskës dhe i gjithë Rusisë
† Kirilli**

Urime të shumta në ditën e emrit të Kryepiskopit Anastas

22 janari për besimtarët orthodhoksë të Shqipërisë ka një kuptim të veçantë. Në ditën kur kujtohet shën Anastas Persiani, kremtojmë edhe emrin e Fortlunturisë së Tij Anastasit, që si vjet përkoji me kremtimin para pak kohe të 80-vjetorit të Kryepiskopit tonë.

Me këtë rast, në kishën "Ungjillëzimi i Hyjlindësës", në Tiranë, u krye Liturgjia Hyjnore, ku me Fortlunturinë e Tij bashkëcelebruan edhe Mitropoliti i Beratit, Hirësia e Tij Ignati, Mitropoliti i Korçës, Hirësia e Tij Joani, episkopët ndihmës, Hirësia e Tij Nikolla dhe Hirësia e Tij Andoni etj.

Kisha ishte mbushur me besimtarë, që kishin ardhur për t'iu uruar Fortlunturisë së Tij jetë të gjatë dhe që ta kemi edhe për shumë vite të tjera në krye të Kishës sonë, jo vetëm nga zona e Kryepiskopatës, por edhe nga të tri Mitropolitë, nxënës të shkollave të hapura me kujdesin e Kryepiskopit, përfaqësues politikë etj.

Hirësia e Tij Nikolla mbajti predikimin e ditës. Ai e uroi Fortlunturinë e Tij, Anastasin, në emër të Sinodit të Shenjtë, të klerikëve e besimtarëve orthodhoksë.



Pas Liturgjisë Hyjnore, në sallën e madhe pranë kishës, në godinën e re të shkollës "Protagonistët", Kryepiskopi priti urimet më të ngrohta nga të pranishmit, të cilët e falënderuan për kontributin e jashtëzakonshëm për ringritjen e Kishës sonë dhe punën e palodhur për ta çuar më përpara atë.

Një moment i veçantë i kësaj dite ishte vizita e urimit e Kryeministrit, Shkëlqesisë së Tij z. Sali Berisha, i cili erdhi në Kryepiskopatën e Shenjtë, ku u prit nga Kryepiskopi Anastas, anëtarë të Sinodit të Shenjtë dhe klerikë. Ai shoqërohej nga Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale, z. Spiro Ksera.

Kryeministri i shprehu Kryepiskopit urimet më të përzemërta personale dhe në emër të qeverisë për këtë ditë të shënuar, duke ritheksuar vlerësimin e veçantë

për kontributin e Fortlunturisë së Tij në krye të Kishës sonë dhe për gjithë shoqërinë shqiptare.

"Ju shpreh urimet më të përzemërta të miat, të qeverisë dhe mbarë shqiptarëve. Ne jemi shumë mirënjohës për të gjithë ndihmesën e jashtëzakonshme që keni dhënë dhe jepni në ringjalljen e fuqishme të këtij vendi dhe këtij kombi. Kam shumë kënaqësi t'ju përcjell urimet e mia më të përzemërta ju dhe Kishës Orthodhokse. Për të gjithë shqiptarët kjo është ditë e veçantë", u shpreh Kryeministri.

Edhe Kryepiskopi i shprehu atij falënderimet për urimet për ndihmesën e dhënë për komunitetet fetare.

Pasditë Kryepiskopi priti përsëri urime në selinë e Kryepiskopatës së Shenjtë nga personalitete, diploma-të dhe shumë besimtarë.

Hapi dyert përkujdesja ditore në Shkodër



Në vazhdim të programit afatgjatë të përkujdesjes sociale të Kishës sonë i shtohet serisë së saj të objekteve të ndërtuara për këtë qëllim një ndërtim i ri, kopshti dhe ambientet për qendrën rinore, ngritur në Shkodër.

E vërteta është se plotësimi i programit në Shkodër ka qenë i vështirë për vetë arsyen se pronat e Kishës Orthodhokse në këtë qytet, me entitet të konsiderueshëm, akoma nuk i janë kthyer. Kështu, si edhe për kishën, është kërkuar me mund dhe më në fund është blerë një truall me sip. 600 m², mbi të cilin u ngrit ky objekt i ri, me fondet e dhëna nga Kryepiskopi Anastas.

Është një ndërtim i thjeshtë, fare pranë qendrës së qytetit dhe shëtitores muzeale të tij, të ngritur së fundmi dhe që edhe për këtë arsye ka një pamje të njëjtë me ndërtimet që përbëjnë zonën në fjalë. Objekti është dykatësh, me sipërfaqe të katit përdhës prej 200 m², në të cilin përfshihen ambientet për përkujdesjen ditore të fëmijëve, ndërsa në katin e parë janë për rininë orthodhokse.

Objekti ka përmirësuar zonën në të cilën është ngritur, duke gërmuar dhe hequr prej andej një vendstrehim të kohës së diktaturës, që prej kohësh ishte degraduar dhe kthyer në vend plehrash.

Kremtohet Shën Vlasi në manastirin që mban emrin e tij

Në Manastirin e Hirshëm të Shën Vlasi u kremtua panairi i shenjtë që mban emrin e këtij vendi të bekuar. Që pasditen e së mërkurës, besimtarë të shumtë mbushën kishën, pavarësisht motit me shi. Shërbesa e Mbrëmësore dhe e Bekimit të Bukëve u kryesua nga Episkopi i Apollonisë njëkohësisht edhe nëndrejtor i Akademisë Teologjike, Hirësia e Tij Nikolla. Pas shërbesës shumë besimtarë darkuan në mensën e Akademisë dhe pastaj u larguan sërish për te kisha e manastirit. Aty u kryen Shërbesa e Paraklisit, e Pasdarkës si dhe të gjithë së bashku bënë leximin e uratave në përgatitjen për kungim. Një ndihmesë të madhe dhanë



studentët e Akademisë dhe nxënësit e liceut kishtar “Kryqi i Nde-ruar”, Sukth, të cilët i gjeje përkrah studentëve në çdo shërbesë.

Ditën tjetër, që në orët e para të mëngjesit, me dhjetëra besimtarë mbushën sërish kishën ku u zhvillua Shërbesa e Mëngjesore dhe Liturgjia Hyjnore. Ato u kryesuan sërish nga Episkop Nikolla. Predikimi, si çdo vit, u mbajt nga një student i vitit të katërt dhe këtë vit i takoi studentit Emiliano Lito. Ai foli për shenjtorin, por bëri një ndërthurje edhe me Ungjillin që u lexua në shërbesë. Deri në orët e vona të pasdites së 11 shkurtit besimtarët vazhdojnë të vijnë në kishë, duke lutur shenjtin për nevojat e tyre që ai të ndërmerojë para Zotit Krisht.

Nestilda Dangaj

Mëshira

“Lum ata që janë të mëshirshëm, sepse ata do të gjejnë mëshirë (Matheu 5:7). Të jesh i mëshirshëm, do të thotë të jesh i ngjashëm me Perëndinë, sepse **“Zoti është i mëshirshëm dhe zemërbutë, i ngadalshëm në zemërim dhe i madh në mirësi” (Psalmi 103:8).**

Dhe Zoti kaloi pranë tij (Moisiut) dhe thirri: “Zoti, Perëndia i përjetshëm, i mëshirshëm dhe i dhembshur, i ngadalshëm në zemërim, i pasur në mirësi dhe në besnikëri, që përdor mëshirën për mijëra njerëz, që fal padrejtësinë, shkeljet dhe mëkatin...” (Eksodi 34:6-7).

Ky është, gjithashtu, mësimi i Krishtit në Predikimin në Mal:

...doni armiqtë tuaj, bëni të mirë dhe jepni hua pa pasur shpresë për asgjë, dhe shpërblimi juaj do të jetë i madh dhe ju do të jeni bijtë e Shumë të Lartit, sepse ai është mirëdashës me mosmirënjohësit dhe të mbrapshtët. Jini të mëshirshëm, pra, sikurse edhe Ati juaj është i mëshirshëm (Lluka 6:35-36).

Të jesh i mëshirshëm nuk do të thotë të justifikosh falsitetin dhe mëkatin. Nuk do të thotë të jesh tolerant për marrëzinë dhe të keqen. Nuk do të thotë të mos vëshre padrejtësinë dhe paudhësinë. Perëndia nuk është në këtë mënyrë dhe nuk e bën këtë.

Të jesh i mëshirshëm, do të thotë të kesh dhembshuri për keqbërësit dhe të të vijë keq për ata që janë kapur në prangat e mëkatit. Do të thotë të heqësh dorë nga çdo vetëdrejtësim dhe çdo vetëjustifikim në krahasim me të tjerët. Do të thotë të mos pranosh të dënosh ata që bëjnë keq, por t'i falësh ata që dëmtojnë dhe shkatërrojnë, si vetet tona, ashtu edhe të tjerët. Do të thotë të thuash me seriozitet të plotë: **“falna fajet tona ashtu sikundër ua falim ne fajtorëve tanë” (Matheu 6:12)**

Sipas Jisuit, personi shpirtëror do të jetë i mëshirshëm, sepse edhe ai vetë ka nevojë për mëshirë. Personi shpirtëror do të jetë i mëshirshëm, sepse ai e di që edhe ai vetë është një njeri mëkatar, i cili ka nevojë për mëshirën dhe ndihmën e Perëndisë. Nuk ka asnjë pa mëkat, asnjë që mund të

pretendojë drejtësi para Perëndisë. Nëse një pretendon se nuk ka mëkat, thotë Shën Joani, ai është një gënjeshtar dhe e bën edhe Perëndinë gënjeshtar (1 Joani 1:10, 2:4). Personi shpirtëror, ngaqë është në bashkim me Perëndinë, i njeh fajet e tij dhe nevojën për falje nga Perëndia dhe nga njerëzit. Ai nuk mund të dënojë të tjerët, sepse ai e di, me përjashtim të hirit të Krishtit, ai vetë është i padenjë dhe i dënuar.

Nëse Ti, o Zot, do të merrje parasysh fajet, kush do të mund të qëndronte, o Zot? Por te Ti ka falje, me qëllim që të kenë frikë prej Teje (Psalmi 130:3-4).

Personi shpirtëror është i mëshirshëm si ndaj vetvetes, ashtu edhe ndaj të tjerëve. Kjo nuk do të thotë se ai i bën të lehta fajet e tij dhe e merr faljen e Perëndisë si të vetvetishme. Por do të thotë se ai nuk e plagos veten me faj dhe keqardhje neurotike, që sjell dorëzimin te skrupuj mëkatarë, të cilët janë vdekja e shpirtit. Do të thotë se ai beson në dashurinë dhe mirësinë e Perëndisë dhe e di, siç thotë Shën Pavli, se asnjë vepër nga vetja e tij nuk do ta çlirojë atë

nga nevoja e mëshirës dhe e dashurisë së Perëndisë.

Ju, në fakt, jeni të shpëtuar me anë të hirit, nëpërmjet besimit, dhe kjo nuk vjen nga ju, po është dhurata e Perëndisë, jo nga vepra, që të mos mburret askush. Ne, në fakt, jemi vepra e tij, e krijuar në Krishtin Jisu për veprat e mira që Perëndia përgatiti që më parë, që ne të ecim në to (Efesianët 2:8-10).

Kështu, është marrja e vazhdueshme e mëshirës së Perëndisë, ajo që e fuqizon shpirtin për vepra të mira. Dhe vetëm i mëshirshmi do të ketë mëshirë prej Perëndisë. Përjetësisht njeriu do të jetë në dispozicionin e mëshirës së Perëndisë. Çfarëdo stadi zhvillimi që ai të arrijë, lutja e njeriut do të mbetet lutja qendrore e Kishës: Zot, ki mëshirë për mua mëkatarin! Më i shenjtë personi, më e madhe është ndjenja e tij e padenjësisë mëkatarë, më e fortë është varësia e tij në mëshirën e Perëndisë dhe më tepër është ai i mëshirshëm ndaj dobësive të të tjerëve.

(Nga “Besimi Orthodhoks”, i atë Thomas Hopko)

Paraqitja e Zotit Krisht në Tempull = Ipapandia

“Të lumur janë ata që banojnë në shtëpinë tënde dhe të himnojnë pa pushim, o Zot” (Ps. 83.5)

Përlëshorja e Ipapandisë Ting. I.

“Gëzohu, o hirplote Hyjlindëse Virgjëreshë, se prej teje ka lindur dielli i drejtësisë, Krishti, Perëndia ynë, që ndrit në errësi. Gëzohu dhe ti, o plak i drejtë që prite në prehrin tënd çlirimtarin e shpirtave, i cili na dhuroi Ngjalljen të gjithëve”.

Dyzet ditë pas Lindjes Trupore të Tij, Krishti u ofrua në Tempull sipas ligjit të Moisiut. Këtë ngjarje feston Kisha jonë e Shenjtë më 2 shkurt.

Më 2 shkurt pra, festojmë një festë zotërore-hyjlindësore. Kjo festë është qendra e festave të shkurtit dhe quhet Ipapandia=Paraqitja e Zotit në Tempull, d.m.th. takimi i Foshnjës Hyjnore me njeriun e moshuar dhe shpirtëror, Simeonin.

Ipapandia e Zotit: Festë e shpërblimit të pritjeve me durim e shpresë.

Ipapandia e Zotit: Festë e Vizitës Hyjnore në zemrat që dinë të presin.

Ipapandia e Zotit: Festë në të cilën rolin kryesor e luajnë këta persona:

- Hyjlindësja me Foshnjën Hyjnore
- Plaku Simeon, hyjpriti
- Profetesha Ana.

Hyjlindësja dhe Foshja Hyjnore

Në librin e Eksodit [në Dhiatën e Vjetër] në kap.13 lexojmë që Perëndia i urdhëroi Hebrejtë të dedikonin çdo fëmijë të parëlindur mashkull tek Ai. Gjithashtu ligji i Moisiut nuk lejonte të hynte në tempull ose të prekte diçka të shenjtë çdo grua për 40 ditë pas lindjes së saj, sepse ishte e papastër.

E Tërshenja me Foshnjën Hyjnore shkon nga Bethlehemi në tempullin e Solomonit, në Jerusalemin, që të ofrojë flijim për pastrimin e saj. Të pasurit sillnin dhe flijonin një qengj, ndërsa të varfrit sillnin dy turtuj ose dy pëllumba të vegjël.

Nëna e Tërshenjtë e Krishtit, si e varfër që është, sjell dy pëllumba në Tempull.

Mbasi Ai Vetë, Fjala e Perëndisë, dha ligjin e Moisiut, kur mori trup njerëzor duhej ta zbatonte, që të mos shfaqej shkelës i tij. Shën Kirilli i Aleksandrisë thotë që **“kur dikush sheh Krishtin të ruajë këtë ligj, nuk duhet të skandalizohet, por të kuptojë më shumë thellësinë e ekonomisë”**.

Gjithashtu, sipas shën Grigor Pallamait, **“Krishti nuk kishte nevojë për pastrim, sepse pastrimi u vendos në Dhiatën e Vjetër, por e bëri për hir të bindjes në Ligjin që Ati vetë dha”**.

Pra, ditën e dyzetë pas lindjes, Foshnja Hyjnore ofrohet në Tempull nga e ëma e Tij. Ky ofrim ka kuptim të dyfishtë:

1. Bekohet e ëma për përfundimin e pastrimit të saj nga gjakrat e lehonisë. Dhe, ashtu si Kisha lutet për çdo sëmundje, kështu lutet edhe për gruan që lindi, sepse është e natyrsme të ndiejë mundim dhe dobësi trupore.

2. Është ceremoni falënderimi për lindjen e fëmijës, sepse zënia dhe lindja e një njeriu nuk është thjesht punë e natyrës, por e fuqisë së Perëndisë, prandaj ndiejmë që i përket Atij. Kështu e ofrojmë te Perëndia

dhe Ai, nëpërmjet priftit, na e jep përsëri që ta rrisim. Por, në të vërtetë, i përket Perëndisë.

Ne, sipas shën Grigorit të Nisës, duhet t’i ofrojmë Perëndisë, në vend të sakrificës së sipërme, pra, **“në vend të çiftit të turtujve dhe në vend të dy pëllumbave për pastrimin e shpirtit e të trupit, sjelljen e mirë jo vetëm para Perëndisë, por edhe para njerëzve”**.

Simeon hyjpriti

Simeoni, që sipas Ungjillit të Llukait ishte “i drejtë dhe shpresëtar”, u bë i denjë të presë Krishtin, ta marrë në duart e tij dhe ta njohë me fuqinë e Shpirtit të Shenjtë. E mban me duart e tij të bukura, me ato duar që shumë herë u lartësuan në lutje te Perëndia për shpëtimin e tij dhe të gjithë njerëzve. Fjala Simeon, në gjuhën hebraike, do të thotë bindje, ose siç thotë shën Joan Gojarti **“ai ishte bindës i Zotit”**. Kishte Frymën e Shenjtë dhe iu dha njoftimi se nuk do të vdiste para se të shihte Krishtin e Zotit. Shën Simeoni erdhi në shenjtërore me fuqinë e Shpirtit të Shenjtë. Kishte Shpirtin e Shenjtë dhe nga Ai mori njoftimin se do të shihte Krishtin para se të vdiste; dhe nëpërmjet Tij erdhi në shenjtërore.

Athanasi i Madh, i frymëzuar nga Shpirti i Shenjtë, i thur lavde shën Simeon Hyjpritisit, i cili u bë i denjë për këtë nder të madh. Thotë që **“Simeoni, për sa i përket natyrës, ishte njeri, por për sa i përket virtytit, ishte engjëll”**.

Profetesha Ana

Në Tempull, përveç shën Simeon Hyjpritisit, ndodhej dhe Ana, profetesha, e cila u bë e denjë të shihte Perëndinë dhe të predikonte që Ai është Shpëtimtari i saj. Ishte vejushë 84-vjeçare dhe jetoj 7 vjet me burrin e saj. Veçori karakteristike e Anës ishte që ndodhej natë e ditë në Tempull dhe nuk largohej asnjëherë nga ai.

Kështu, ndërsa Simeoni u udhëzua nga Shpirti i Shenjtë në Tempull, ajo qëndronte atje në Shpirtin e Shenjtë dhe pa Perëndinë me sytë e saj.

Të dashur motra dhe vëllezër! Ja mesazhet shpirtërore që na jep festa e Ipapandisë:

a. Bindje absolute në ligjin e Perëndisë. Vetëm me dashurinë për Perëndinë dhe njerëzit do të takojmë Krishtin. **“Mirësia e shpirtit vjen nga bindja ndaj Perëndisë”**, thotë shën Joan Gojarti.

b. Duhet të ketë dikush Shpirtin e Shenjtë dhe të mësohet prej tij. Ai [Shpirti i Shenjtë] nuk iu zbulon mistere njerëzve që janë të papastër. Askush nuk mund t’i afrohet Perëndisë, nëse nuk ka fuqi shpirtërore, d.m.th. nëse nuk forcohet nga fuqia e Shpirtit të Shenjtë.

c. Profetesha Ana qëndronte natë e ditë në tempull. Ambienti ynë më i dashur, vendi, që do të qetësojë shpirtin tonë, duhet të jetë Tempulli, dhe më konkretisht, Kisha, sepse është një dorë që tregon Qiellin. Profeti David na thotë:


“Të lumur janë ata që banojnë në shtëpinë tënde dhe të himnojnë pa pushim, o Zot” (Ps. 83.5).

Përktheu Rozeta Baba



“Lum ata që zgjodhe dhe që i more, o Zot”.

Fjala përkujtimore e Kryepiskopit Anastas për atë Spiridhon Simandirin



Vëllezër dhe motra besimtarë,

Atë Spiridhon Simandiri ishte një fizionomi e veçantë, që jetoi thirrjen e tij priftërore me një mënyrë tërësisht të përkushtuar, me dashuri konkrete mahnitëse.

Të gjithë do ta kujtojmë me mirënjohje. Ende laik, ai ishte njeriu që e ofronte përherë veten e tij për të shërbyer. Edhe ne më të vjetrit e kujtojmë pranë njerëzve të bekuar, të cilët e nderuan Kishën tonë: pranë profesor Ciridianit dhe më vonë pranë Kryepiskopit të mrekullueshëm të Athinës dhe gjithë Greqisë, Jeronimit I. Ai ishte gjithmonë njeriu që ofrohej për të shërbyer dhe për të dhënë zgjidhje në çdo problem praktik që mund të shfaqej.

Pas studimeve të tij juridike, punoi si gjykatës dhe kujdestar minoritësh. Ai u përkujdes gjatë gj-

thë kohës me dhembshuri dhe interesim të drejtpërdrejtë për të lehtësuar dhimbjet, për t'i ngushëlluar, për t'i fuqizuar e udhëhequr drejt Krishtit. Edhe në dhjetëvjeçarët e fundit, kur vendosi t'i përkushtohet tërësisht Kishës si prift, ishte ai që vrapoi me të vërtetë si shqiponjë nga një cep i Shqipërisë dhe i Greqisë në cepin tjetër, për të ndihmuar, për të transmetuar mesazhin e Ungjillit, për të mbështetur dhe ngushëlluar njerëzit.

Si kryepiskop, do ta kujtoj përherë me mallëngjim të thellë, sepse ishte një nga bashkëpunëtorët e mi më të mirë, i palodhur, gjithmonë frytdhënës në çdo lloj fronti ku punonte, si në Afrikë, ku jetuam bashkë për një kohë të shkurtër, ashtu dhe në vitet e fundit në Shqipëri. Ai ishte me të vërtetë njeriu që i përgjigjej çdo nevojë “si përgjegjës për furnizimet”. Qoftë qytet apo fshat, qoftë shkollë apo enori, atë Spiridhoni gjithnjë ishte ai që realizonte mendimet dhe vendimet tona dhe jepte përherë zgjidhje, “pa ndërprerje” siç thotë Apostulli Pavli. “Përkujtojmë veprën e besimit, të mundimit të dashurisë dhe të durimit të shpresës” të vëllait. Besimi i tij kthehej vazhdimisht në vepër, çdo vepër e tij ishte e brumosur me një

besim të zjarrtë dhe me gjithë shpirt. Dashuria e tij ishte përherë e lidhur me mundim dhe vetësakrificë dhe çdo mund i tij ishte gjithmonë i pa-interes. Ishte njeriu i durimit dhe i shpresës, madje edhe në raste të pashpresa. Duroi një sërë sprovash, si të brendshme dhe të jashtme, duke e pasur përherë vështrimin në personin e Zotit tonë, për të Cilin i la të gjitha.

Me falënderim mburremi për të gjithë anëtarët e familjes së tij, fëmijët dhe bashkëshorten e tij të zgjedhur, nipërit por njëkohësisht, atë Spiridhoni bëri familje të tij, të gjithë Kishën që kishte nevojë për të.

Kisha e Shqipërisë, në mënyrë të veçantë, e ndien si bamirës të saj të madh. Prandaj edhe sot jemi mbledhur këtu për t'i shprehur mirënjohjen tonë. Por mendoj se edhe Kisha e Greqisë në personin e tij gjeti një njeri të mrekullueshëm, i cili plotësoi shumë boshllëqe. Shumë shpesh mendojmë se frontet e vështira janë për murgjit, për ata që janë tërësisht të përkushtuar dhe harrojmë se çdo prift është një sakrificë e gjallë për Krishtin tonë. Atë Spiridhoni jetoi në këtë mënyrë. Bën pjesë në brezin e atyre që e morën Krishtin shumë seriozisht, jo thjesht si një mësues dhe udhërrëfyes, por si Zotin e Kryqëzuar

dhe të Ngjallur dhe përpiqej ta përjetonte gjithnjë këtë mister në gëzimin e shpresës dhe të Ngjalljes. Prandaj mbetet edhe një udhërrëfyes i mrekullueshëm si për klerikët, ashtu edhe për laikët. Jetoi misterin e dashurisë dhe të vetësakrificimit. Ishte ai i cili jo thjesht jetoi urdhëresën themeltare të dashurisë, por, duhet të shtoj, jetoi edhe porosinë e fundit të Zotit, që shumë shpesh harrohet “shkoni mësoni të gjitha kombet...”. Duke qenë i pranishëm në zona dhe fronte që për të tjerët ishin shumë të largëta dhe nuk njiheshin.

Kujtimi i tij do të jetë i paharruar dhe i gjallë. Do të kujtojmë njeriun e Perëndisë të hirshëm, burror dhe të painteres, i cili me thjeshtësi dhe me natyrshmëri të pashterur, me një origjinalitet në mënyrën si punonte, ka lënë gjurmë të pashlyeshme si në Kishën e Shqipërisë, ashtu dhe në atë të Greqisë por edhe në mbarë Kishën Orthodhokse. Shenjtorët nuk i takojnë një vendi dhe një Kishë lokale, shenjtorët tejkalojnë vendin dhe kohën. Dhe bëjnë pjesë në mbarë Kishën Orthodhokse. Atë Spiridhoni ishte ai që jetoi atë që dëgjuam në Ungjill, “ai që beson tek unë edhe po të vdesë, do të jetojë” sepse nuk kërkonte vullnetin e tij, por të Atit që e ka dërguar. Sa patëm gëzimin ta njohim, të jetojmë dhe të bashkëpunojmë me të, ndiejmë se Perëndia na fali një bekim unikal në personin e tij.

Në fund, dëshiroj të shpreh me gjithë zemër, ngushëllimet e mia për familjen e shtrenjtë të tij dhe ndaj gjithë atyre që vajtojnë në këtë ditë për largimin e atit të shtrenjtë Spiridhoni. Perëndia të denjësojë edhe të tjerët që të ndjekin shembullin e tij dhe figura e tij do të jetë gjithmonë udhërrëfyes si për Kishën e Shqipërisë, ashtu edhe për atë të Greqisë.

“Lum ata që zgjodhe dhe që i more, o Zot.”



*Të dielën,
më 31 janar, në
kishën “Ungjillëzimi
i Hyjlindëses”
në Tiranë u bë një
Përshpirtje në 40 ditët
e fjetjes së atë
Spiridhonit.
Në të u lexua fjala
përkujtimore e
Kryepiskopit Anastas
që po botojmë këtu.
1993 - Atë Spiridhoni
gjatë shenjtërimit të
kishës “Ungjillëzimi
i Hyjlindëses
(i pari majtas).*

PJESË MONOGRAFIE PËR IMZOT EVLOGJIO KURILLËN

Midis mendimtarëve klerikë të kohëve moderne mitropolit i Korçës, Evlogjio Kurilla, falë aktivitetit të tij shkencor, botues dhe mësimdhënës zë një vend tepër të veçantë. Tek Evlogjio Kurilla, ekzistonin së brendshmi të alternuara konsekuenca fetare dhe ajo shkencore. I lindur në Ziçisht të Korçës në vitin 1880, prej një fisi të dëgjuar me origjinë nga Kurilla e Sulit, mësimet e para i ka marrë në shkollën e fshatit të lindjes, për t'i vazhduar më pas në shkollën e Athosit në Malin e Shenjtë, në Athoniadhë, ku kishte shkuar me babanë e tij që në moshën dymbëdhjetëvjeçare për të punuar në përgatitjen e qymyrit të drurit, pranë manastirit të Llavrës. Në përgjithësi kurbeti në Mal të Shenjtë, ku punohej kryesisht për nxjerrjen e qymyrit të drurit dhe ndërtimit, ka qenë një traditë e hershme e vazhdueshme e fshatrave të Devollit të Sipërm. Këtu Ilia dorëzohet murg në manastirin e Llavrës, duke marrë emrin Evlogjio (i bekuar).

Kjo zgjedhje që ai bëri, premtonte para së gjithash një jetë të mundimshme dhe plot privacione. Është për t'u shënuar fakti se pavarësisht këtyre, Evlogjio gjeti kohën jo vetëm të ishte një murg shembullor, por edhe të arsimohej më tej në mënyrë autodidakte, në kushte dhe rrethana të pazakonta. Për këtë më mirë po i referohemi përshkrimit që i bën jetës së Evlogjios dhe pasionit për dije që e shoqëronte, miku i tij jurist Dhimitër Andipas: "Tepër i varfër, por i pasur në dhunti shpirtërore, ka qenë epiroti i vogël Kurilla në luftën e jetës. Pothuajse të gjithë jetën e tij e kalon si eremit në Mal të Shenjtë, në mes të dhimbjeve dhe mundimeve, privacioneve dhe vuajtjeve. Por edhe atje, në vendin e shenjtë të lutjes dhe të kreshmës, nuk qetësohet, nuk ia lejon vetes çlodhjen, për asnjë çast. Orët e pakta që i mbeten nga puna e mundimshme e një murgu të vërtetë rigoroz, nuk i përdor si zakonisht njeriu për gjumë dhe çlodhje, por në një masë të madhe këto orë i shfrytëzon për studim dhe vetëzhvillim. E prishi shëndetin që në moshë të re 15-vjeçare në studime dhe shpjegime autorësh, duke pasur për ndihmë vetëm fjalorin. Në këtë situatë mjekët ia ndaluan çdo lloj studimi, masë që iu vu dhe nga eprori i tij në manastir, ndërkohë që Evlogjio priste sa i zinte gjumi të tërë, për t'u dhënë në kënaqësinë shpirtërore të studimit. Kështu në atë vend i vetmuar, duke shfrytëzuar bibliotekat e pasura të manastireve të shenjtja, u dha pas studimeve dhe hulumtimeve të thella, mësoi në mënyrë autodidakte katër gjuhë evropiane dhe u zhvillua në një meteor të ndritshëm, duke i çuditur me diturinë e gjerë dhe pasurinë e njohurive vizitorët e huaj të ditur. (Dhimitër Andipas, jurist i Gjakatës së Lartë të Greqisë, Athinë 1944.)

Mbasi kryen ciklin mësimor në shkollën e Athoniadhës, ai shkon për studime në Shkollën

e Madhe të Genit, në Kostandinopojë. Mbas studimeve atje, falë zellit të madh për dituri që e karakterizonte, regjistrohet në fakultetin teologjik dhe pas dy vjetësh studime të suksesshme regjistrohet në seksionin filologjik të fakultetit Filozofik të Universitetit Shtetëror të Athinës, studime të cilat i mbaron me sukses në vitin 1912, ku diplomohet shkëlqyeshëm, për t'i plotësuar më pas me studimet e doktoraturës, të cilat i mbaron po shkëlqyeshëm, duke marrë titullin e doktorit në vitin 1935, me punimin e tij për Voskopojën dhe Akademinë e saj. Mbas studimeve të tij universitare, në vitin 1915 emërohet profesor në gjimnazin C të Athinës, ku punoi me devocion dhe përkushtim deri në vitin 1923, kur jep dorëheqjen për të shkuar në Mal të Shenjtë.



Aty ai ringre shkollën kishtarë të Athoniadhës, ku ushtron përsëri profesionin e mësimdhënësit. Kjo shoqërohet me një aktivitet të gjerë hulumtues. Kështu do të jetë E. Kurilla, ai që do të inventarizojë arkivat dhe bibliotekat e manastireve aty dhe do të impenjohet për mbrojtjen dhe ruajtjen e thesareve të çmuar dhe unikalë, që për shekuj ishin krijuar dhe ruajtur në këtë fortesë shpirtërore të besimit Orthodhoks.

Pas marrjes së titullit "Doktor" në vitin 1935, siç u tha më lart, emërohet profesor i historisë në Universitetin e Selanikut, ku vazhdon të japë mësim deri në emërimin e tij nga Patriarkana Ekumenike e Kostandinopojës si mitropolit i Korçës, mbas dhënies prej saj të Autoqefalisë së Kishës Shqiptare (1937).

Mitropolia e shenjtë e Korçës, në kohën që erdhi si mitropolit i saj Evlogjio Kurilla, në prill të vitit 1937, ndodhej në një situatë të vështirë

zbehjeje. Në përgjithësi para Sinodit të Shenjtë të ri të Kishës Orthodhokse Autoqefale Shqiptare, si dhe para çdo mitropolit të emëruar në mitropolitë më të rëndësishme të Kishës Orthodhokse në Shqipëri, shtroheshin sfida të shumta për t'u përballuar dhe zgjidhur. Është një periudhë e cila është paraprirë nga një situatë e trazuar plot mllafe, amulli dhe aprofesionalizëm në sistemin administrativ të Kishës Orthodhokse në Shqipëri. Le të kujtojmë këtu kërkesën për falje, për shkeljet e rënda që ishin bërë në funksionimin e sistemit administrativ dhe jo vetëm në të, nga kryepiskopi i atëhershëm Visarion Xhuvani, para dorëzimit të Tomos-it të Autoqefalisë nga Patriarkana Ekumenike. Veçanërisht një situatë e vështirë ekzistonte dhe në mitropolinë e Korçës, situatë të cilën u përpoqën ta shfrytëzojnë arbëreshët unitë të Sicilisë, të cilët u shfaqën këtu në këtë kohë si shpëtimtarë të Krishterimit, duke hapur shkolla dhe kishë unite dhe duke bërë një politikë proselitizmi nëpërmjet të mirave materiale, bursave dhe pagesave. Me vendosjen e imzot Kurillës si mitropolit në qytetin e Korçës, sfida e parë me të cilën ai u përball me sukses ishte ndërgjegjësimi i popullatës ndaj këtyre politikave të proselitizmit që bëheshin dhe kthimi i atyre që u lëkundën në besimin e të parëve. Nga katërqind nxënës të kthyer në unitë në qytetin e Korçës, nuk mbeti më asnjë i tillë kur ai u largua nga kjo mitropoli, të gjithë iu rikthyen besimit Orthodhoks.

Një angazhim serioz i tij kishte të bënte edhe me sistemimin e strukturës administrative të kësaj mitropolie. Kështu ai luftoi me mish e me shpirt për rikthimin e shkëlqimit të parë të kësaj qendre të rëndësishme religjioze.

Gjithashtu, sa kohë qëndroi në Korçë, ai vizitoi edhe fshatrat më të skajshme të zonës së tij, për herë të parë, ndoshta mbas shumë shekujsh, këto fshatra panë interesin e drejtpërdrejtë të bariut të tyre shpirtëror dhe u vizituan nga një mitropolit. Paralelisht me detyrat shpirtërore të tij në këto mbi 120 fshatra, që i vizitoi në mënyrë të përsëritur, për sa kohë qëndroi në këtë detyrë, ai mblodhi shumë materiale dhe të dhëna historike, folklorike dhe arkeologjike, të cilat i pasqyroi në veprat e tij. Por kulmi i suksesit të imzot Kurillës si mitropolit ka qenë ngritja e seminarit elitar kishtar "Jovan Banga" në qytetin e Korçës, për përgatitjen e klerikëve dhe punonjësve të kualifikuar të Kishës Orthodhokse në zonën e Korçës dhe më gjerë. E. Kurilla ndërmori iniciativën për hapjen e këtij seminari kishtar në qytetin e Korçës me fondet e një prej bamirësve të këtij qyteti, Jovan Bankës.

Për të si klerik, si studiues dhe si historian, që e njihte të kaluarën më mirë se kushdo, ishte një nder i madh dhe njëkohësisht një obligim

(vijon në faqen 8)

PJESË MONOGRAFIE PËR IMZOT EVLOGJIO KURILLËN

(vijon nga faja 7)

shumë i madh qëndrimi në fronin mitropolitan të këtij qyteti, i cili mbartte një traditë dhe trashëgimi tepër të çmuar. Për këtë arsye dhe impenjimi i tij ishte tërësor. Ai nuk bëri asnjë kompromis në kurriz të besimit apo vlerave shpirtërore dhe materiale të kësaj mitropolie që drejtonte, gjë që i kushtoi atij dhe largimin nga ky pozicion disa muaj mbas pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste. Lufta që ai i bëri Unizmit, si dhe lufta e hapur në rrugë gjyqësore ndaj të gjithë uzurpuesve të pasurive materiale të Mitropolisë së Korçës, në periudhën e amullisë, para ardhjes së tij në krye të kësaj kishë, i kushtuan atij largimin nga funksioni fisnik, që ai kryente me kaq përkushtim dhe vetësakrificim.

Për korçarët E. Kurilla mbeti gjithmonë bari shpirtëror i pazëvendësueshëm i tyre dhe titullin si mitropolit kanonik i kësaj mitropolie e ruajti gjatë gjithë jetës së tij pavarësisht rrethanave, duke u shfaqur si mitropolit i Korçës në të gjitha punimet, botimet e tij shkencore, si dhe në pjesëmarrjet në konferencat e ndryshme ndërkombëtare të karakterit fetar dhe shkencor, qysh nga viti 1937 deri sa ai kaloi në dimensionin tjetër, në atë të jetës së vërtetë, në prill të vitit 1961 të shekullit të kaluar, duke promovuar dhe nderuar qytetin e Korçës, bir dhe bari shpirtëror i denjë i të cilit mbeti deri në fund.

Mbas njoftimit zyrtar të datës 29 shtator 1939, firmosur nga Xhafer Ypi (ministri i vënë nga pushtuesit italianë *sh.r.*), sipas të cilit duhej

të largohej nga Korça, Kurilla vendoset në Athinë, ku emërohet profesor i historisë në Fakultetin Filozofik të Universitetit Shtetëror atje. I njohur në rrethet akademike të kryeqytetit grek nëpërmjet botimeve dhe i vlerësuar edhe në rang ndërkombëtar për dijet dhe nivelin e tij shkencor, i propozohet që të drejtojë edhe në katedrën e sapokrijuar të historisë së periudhës romake, në Fakultetin e Historisë të këtij universiteti, kjo për arsye se historia e vjetër dhe kryesisht periudha helenistike studiohej në këtë universitet deri atëherë e përpunuar, e marrë së bashku.

së Vërtetës”. Gjithashtu, nëpërmjet kësaj veprë ai donte t’iu bënte të ditur të gjithëve se qëllimi i tij ishte, që nëpërmjet studimeve krahasuese historike, gjuhësore e filologjike të kulturave të këtyre dy popujve të lashtë të rajonit, atij grek dhe shqiptar, t’iu mëshonte të përbashkëtave të shumta që i lidhnin këta popuj, pasi vetëm kështu do të arrihej një paqe dhe ekuilibër në zonën e trazuar të Ballkanit. Ai iu referohet analizave gjuhësore të këtyre dy gjuhëve, ku evidenton shkencërisht elementin pellazgjik të ruajtur në formën më të mirë të mundshme në gjuhën

dukur veprës së tij. Të gjitha këto përfshihen në këtë libër, i cili ka rreth 330 faqe dhe më tepër se një apologji është një leksion emancipimi për trutë e ngushtë dhe manipulorët e historisë së popujve, për ata që nëpërmjet fodullëkut pa bazë të supremacisë boshe arrijnë vetëm të bëhen qesharakë...

Mbas vitit 1945 ai e kalon jetën sa në shtëpinë e tij, në lagjen Psiqiko të Athinës po aq dhe në manastirin e Llavres, në Mal të Shenjtë, duke shkruar dhe hulumtuar deri në fund të jetës së tij dhe duke ëndërruar gjithmonë kthimin në detyrën e tij pranë Mitropolisë së Korçës.

Fryt i punës së tij si bukinist selektiv ka qenë një bibliotekë e pasur me më shumë se 20.000 vëllime, punë e një jete të tërë të përkushtuar ndaj librit, ku një numër të konsiderueshëm zinin botimet e rralla që ai për dhjetvjeçarë të tërë me durim dhe këmbëngulje diti t’i mbledhë. Dëshira e tij ishte që kjo bibliotekë kaq e pasur, kryesisht edhe me botime të rralla albanologjike, t’i kalonte qytetit të Korçës. Duke qenë e pamundur kjo gjë, pasi ai ndërroi jetë në prill të vitit 1961, pjesa më e madhe e saj pas vdekjes i kaloi Universitetit të Janinës, ndërsa një pjesë e konsiderueshme, së bashku me shumë dorëshkrime të pabotuara mbeti në bibliotekën e manastirit të Llavres, në Mal të Shenjtë.

Me një formim të përkryer shkencor, fryti i punës së tij dhe aktivitetit shkencor janë studimet e tij albanologjike, helenistike dhe ballkanistike, të cilat janë të karakterit filologjik, lingvistik dhe historik. Të gjitha këto janë të një niveli akademik dhe shquhen për objektivitet shkencor dhe profesionalizëm. Si specialist i rrallë në fushën e studimeve historike, kontributi i tij me studimet e dorëshkrimeve të bibliotekave të Malit të Shenjtë, manastireve të Meteorës, manastirit të Patmosit dhe bibliotekave të Athinës dhe të gjithë Greqisë ka qenë kolossal dhe me një impakt të tillë që kapërcente kufijtë e Ballkanit, duke e bërë të njohur atë në rrethet akademike të Evropës. Punimet e tij të botuara arrijnë në dyqind e gjashtëdhjetë.

Dr. Dion Tushi

Marrë me shkurtime nga revista "Tempulli" nr. 14, Korçë



Të gjitha këto sulme ai i përballoi me guxim dhe kurajë, kurrë nuk revizionoi mendimin e tij dhe mbrojtje me kompetencë dhe profesionalizëm punën dhe mendimet e tij. Të gjitha këto ai i ka përjetësuar në mënyrën më të bukur dhe impresionuese në veprën e tij "Pushteti i

shqipe, i mëshon heroizmave dhe origjinës së sulioteve, pasi edhe ai vetë ishte një suliot në origjinën e tij kap të përbashkëtat në impenjimet e përhershme të këtyre dy popujve për indipendencë dhe arsimim dhe arrin në konkluzionin se e ardhmja ndoshta do t’i japë dimensionin e



Kopshti "Frymë Dashurie" pranë kishës "Shën Nikolla" në Kavajë organizoi në fund të janarit festën "Takim brezash". Pas më shumë se 10 vjet pune e veprimtarie të gjallë, gjeneratat vendosën të mblidheshin brenda ambienteve të kopshtit. "Është kënaqësi të shikojmë të takohen me njëri-tjetrin përfaqësues të brezave të mëparshëm. Ata u rritën dhe morën njohuritë e tyre të para në këtë kopsht. "Jemi mbledhur të përjetojmë edhe njëherë me mall këtë histori të vyer", - tha përgjegjësja e kopshtit, znj. Dhurata Xoxi.

Fëmijët treguan para të pranishmëve ato çfarë kishin mësuar në kopsht dhe kishin përgatitur një program shumë të bukur artistik, ku morën pjesë vajza dhe djem, të cilët kanë qenë në këtë kopsht, duke kënduar këngë që kishin mësuar aty. Një ndërthurje e këndshme vullnetesh që ishin bërë një në atë moment.

I. K.

Ata që punuan për Kishën tonë

Personalitet me kulturë dhe horizont të gjerë

Dhimitër Vangjel Përmeti ka lindur më 1878 në Lipë, Përmet. Shkollën e mesme e kreu me rezultate të shkëlqyera në Turqi dhe në gjimnazin e famshëm "Zosimea", në Janinë, Greqi. Pas mbarimit të studimeve caktohet mësues në ishullin e Kretës, në Greqi. Kthehet në Shqipëri rreth vitit 1920 dhe vendoset në lagjen Mangalem të Beratit.

Dhimitri zotëronte gjuhët: greke, franceze, angleze, turke dhe italiane, të cilat i vuri në përdorim për të shkruar shumë libra dhe për t'ua transmetuar dijet nxënësve të tij, kur ushtroi profesionin e mësuesit në shkollën qytetëse të Mangalemit. Si mësimsdhënës, ai ka dhënë lëndë të ndryshme, duke përfshirë edhe mësimin e besimit orthodhoks.

Në saje të erudicionit të lartë që kishte, emërohet drejtor i parë i Seminarit Orthodhoks Kombëtar "Apostull Pavli", që u themelua në vitin 1930.

Duke qenë drejtor dhe pedagog në këtë Seminar, nuk reshti për asnjë çast të shkruante libra me karakter fetar, si p.sh. "Katekizma e Krishtenë Orthodhokse", aprovuar dhe botuar

prej Sinodit të Shenjtë të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë në vitin 1932, ku përfshihen 25 kapituj.

Më vonë boton librin në dy pjesë me titull: "Fjala e mirë", që daton vitin 1943.

Ka lënë edhe një dorëshkrim të titulluar: "Arsimi në Berat 1778-1944.

Qysh në rininë e hershme e deri në vitet e pleqërisë së thellë ka qenë vazhdimisht i aktivizuar në kishat e vendit tonë, duke psalur me zërin e tij të ëmbël dhe melodioz.

Ky njeri me një kulturë dhe horizont të gjerë ndërroi jetë më 11 janar 1963. Për kontributin e tij në arsim, në vitin 1993, Presidenti i Republikës.

i akordoi z. Dhimitër Vangjel Përmeti (pas vdekjes), titullin "Mësues i merituar", me motivacionin: "Poliglot e i pajisur me kulturë të gjerë, është angazhuar në shkrimin e mësimeve shkollore e të veprave fetare".

Figura madhore e të ndjerit Dhimitër Vangjel Përmeti kujtohet e do të kujtohet me respekt të veçantë, në jetë të jetëve, nga ish-nxënësit e tij, nga besimtarët orthodhoksë dhe nga mbarë qytetarët beratas e më gjerë, të cilët kanë në zemër e në mendje mësimet e tij, kushtuar, me aq devotshmëri edukimit qytetar, shoqëror, kulturor dhe fetar të të gjithave shtresave njerëzore.

Ilia M. Zaka

RADIO "NGJALLJA", NË FM 88.5 MHz.

Ajo transmeton për ju 24 orë program.

Do të dëgjoni gjithçka që ju duhet: programe shpirtërore, sociale dhe kulturore.

Muzikë e zgjedhur kishtarë, popullore dhe klasike, nga vendi dhe bota.

Ndiqni shërbesat kishtarë në Radio "Ngjallja"!

Orthodhoksët e Beratit për ringjalljen e fesë

Para pak kohësh, besimtarët e Beratit patën në duar librin e z. Ilia M. Zaka "Kisha e Shën Spiridhonit dhe veprimtaritë kishtarë në Berat (1990 - 2008)", libër që u shpërnda menjëherë dhe kërkohet ende sot nga të gjithë beratasit e më tej.

Pse? Sepse secili besimtar gjen veten aty, lexon përpjekjet që ka bërë dhe vë re gjurmët që ka lënë në ato momente të vështira por historike, por edhe në luftën e mëtejshme për të ringritur kisha, për t'i bërë funksionale dhe për t'i mbushur me besimtarë.

Është një libër plot me fakte dhe fotografi, që ndjek hap pas hapi jo vetëm ngjarjet, por dhe veprimtarët që i kryen ato, që nga lëvizjet e para, nëntor 1990, për rihapjen e kishës së Shën Spiridhonit e deri në ditët tona, në misionin e ringjalljes së fesë në shpirtat tanë.

Përfshihen aq shumë ngjarje e persona në të, sa që mund të thuash se nuk është një libër i z. Ilia dhe për të, por një libër i gjithë anëtarëve të komunitetit orthodhoks në Berat për veprën e tyre.

Në të pasqyrohet e shprehet veprimtaria në zonë, por dhe zhvillimi i paparashikuar që mori Kisha jonë, sidomos me ardhjen, punën e palodhshme dhe kontri-

butin e Kryepiskopit të nderuar Anastas, gjë të cilën nuk mund ta mendonin nismëtarët që luftonin me aq shumë vështirësi të hasura.

Dhe për të shkruar një libër të tillë, duhet të kesh ndjekur personalisht ngjarjet, jetën e Kishës, si mendërisht edhe fizikisht, të kesh punuar për ecurinë e ringjalljen e saj, të jesh besimtar i devotshëm që të pasqyrosh me vërtetësi punën e të gjithëve.

E pikërisht kjo ka ndodhur me z. Ilia. Ai e ka ndjekur dhe e ndjek zhvillimin e kishës, duke mbajtur dhe shënimet përkatëse, jo vetëm në Berat, por në tërë mitropolinë.

Duke qenë i sigurt për sa ai ka jetuar, parë e dëgjuar, për sa kanë ngjarë ai mori përsipër të realizojë këtë detyrë të vështirë, por të nderuar dhe me aq përgjegjësi. Libri doli dhe fjalë të mira u dëgjuan dhe mund të themi se është një gur themeli që u vjen në ndihmë atyre që do të shkruajnë historinë e Kishës sonë Orthodhokse.

Kisha e Shën Spiridhonit dhe veprimtaritë kishtarë në Berat
Historiku 1990 - 2008



Mbasi ke lexuar librin, vë re se është arritur qëllimi: faktimi i përpjekjeve, i luftës së besimtarëve për kapërcimin e pengesave, si dhe lulëzimi e funksionimi i fesë në këtë mitropoli.

Dhe kjo është arritur falë devotshmërisë së besimtarëve tanë, drejtimit të mirë dhe punës së vazhdueshme të hierarkëve tanë, Kryepiskopit Anastas dhe Mitropolit Ignatit.

Kristofor Beduli



NGJALLJA

Organ i Kishës Orthodhokse
Autoqefale të Shqipërisë

Themelues:
Kryepiskopi Anastas

**Del nën kujdesin
e Këshillit Botues**

Kryeredaktor: Thoma Dhima

Adresa:

**Kryepiskopata Orthodhokse,
Rruga e Kavajës, Nr. 151
Tiranë**

Tel: (04) 2234 117, 2235 095.

Fax: 2232 109

Shtypur

në shtypshkronjën "Ngjallja"

MEDITIME TË SHKRIMTARIT NIKOLLAJ GOGOL PËR LITURGJINË HYJNORE

Në vitin 1902 u botua në gjuhën ruse në Berlin një *Liturgjikë* ku përfshiheshin edhe *Meditimet* e Gogolit, të shoqëruara dhe me një përkthim në gjermanisht. Në faqen e parë të këtij botimi, përkthyesi i tij, protopresviteri Aleksii Malzov shënon:

“Për një shkak, që është tërësisht i pakuptueshëm, eseja e bukur e Gogolit me titull *Meditime për Liturgjinë Hyjnore*, nuk ka gjetur vend në asnjë nga botimet e veprave të tij që konsiderohen të plota. Kjo ka ndodhur në të gjitha botimet e veprës së tij të plotë, përveç asaj të Marx, i cili është edhe botuesi i revistës *Niva*.

U botua për herë parë në vitin 1857 (pesë vjet pas vdekjes së shkrimtarit në moshën 43 - vjeçare), në Shën Petërsburg, nga P. A. Kulish edhe në formën e një botimi të pavarur. Më vonë u botua edhe nga Sinodi i Shenjtë i Kishës së Rusisë...”.

Qysh nga ajo kohë dhe deri në ditët tona, *Meditimet* janë përkthyer, shtypur dhe kanë qarkulluar shumë herë dhe në mjaft gjuhë të tjera.

Më poshtë po japim dy fragmente, hyrëse dhe përmblyëse, të kësaj dëshmie të rrallë besimi.

LITURGJIA HYJNORE

“Liturgjia Hyjnore është, sipas një pikëpamjeje, përsëritja e vazhdueshme e shprehjes më supreme të dashurisë, që u shfaq “një herë e mirë” për hirin tonë. Raca njerëzore, duke vajtuar në çdo cep të globit për apostazinë e saj, i thërriste Krijuesit të saj me përgjëratë. Brenda errësirës mbylëse të idhujtarisë dhe në mosnjohjen e Perëndisë, njeriu ndiente se rregulli dhe harmonia nuk mund të sundonin përsëri në tokë, përveçse me anë të Atij që urdhëroi gjithësinë të lëvizjeve me harmoni.

Krijesa, duke psherëtirë, i thërriste Krijuesit të saj. E paaftë jo vetëm për të kuptuar mesazhet plot kuptim të fakteve që përsëriten gjithmonë në botën e Perëndisë, por edhe të dallojë edhe një gërmë të vetme edhe sikur të harxhonte shekuj përpjekjesh për këtë gjë - krijesa rrinte në pritje me shpresë se do të ndriçohej me mësimin e vetë Krijuesit të saj.

Gjithësia vazhdimisht thërriste dhe luste Shkaktarin e ekzistencës së saj dhe ato thirrje dëgjoheshin më të thekshme teksa dilnin nga gojë e të zgjedhurve dhe të profetëve të tij. Kjo sepse ata e ndienin dhe e njihnin se nëse Krijuesi do të shfaqej te njeriu, këtë do ta bënte me formën e krijesës së Tij, të krijuar sipas ikonës dhe shëmbëllimit të Tij.

Prania Hyjnore mbi tokë u bë e dukshme ndër të gjithë, tek secili sipas shkallës së pastërtisë që ideja

e Perëndisë kishte përbrenda tij. Por qartë në lidhje me atë folën vetëm profetët e popullit të zgjedhur.

Trupëzimi i panjollë i Zotit nga Virgjëresha e tërëdlirë, ndërsa ishte një shpresë madje edhe e idhujtarëve, u shpall më saktë vetëm nga profetët.

Thirrjet përgjëruese u dëgjuan. Në botë u shfaq Ai që krijoi botën. U shfaq në mes tonë, i ngjashëm me ne, në formë njeriu, siç e prisnin edhe ata që ndodheshin në errësirat e paganizmit - por jo siç e kishte fantazuar mendja e tyre e ndotur: Jo në mes të një lavdie dhe madhështie të përmbishkëlqyer; jo si shpagues i së keqes, jo si gjykatës, që disa do t'i dënonte dhe disa do t'i shpërblente. Jo. Erdhi ashtu siç vetëm Perëndia do të mund të vinte.

* * *


Liturgjia Hyjnore ka diçka që është e veçantë dhe që nuk ka të çmuar: kryerja e saj bëhet në mënyrë publike, para syve të të gjithëve dhe megjithatë është një mister që nuk mund t'i afrohet kush.

Nëse besimtari merr pjesë në çdo fazë të saj me shpresëtarë dhe vigjilencë, shpirti i tij do të lartohet; përmbushja e porosive të Krishtit do t'i duket e lehtë, zgjedha e Krishtit do të jetë për atë e butë dhe barra e tij e durueshme. Kur besimtari del nga Kisha, ku mori pjesë në Darkën e Dashurisë, ai shikon në fytyrat e të gjithë njerëzve vëllezërit e tij. Gjatë punëve të përditshme që kryen, në punë ose në shtëpi ose kudo tjetër ku ndo-

dhet, ruan pa u sforcuar brenda tij vendimin e lartë të një marrëdhënieje të tillë vëllazërore me të gjithë, sikundër frymëzohet nga dashuria, që Perëndinjeriu e sollti nga qiejt. Nëse sheh dikë që ka nevojë, zemra e tij do të nxisë më shumë se herët e tjera për t'i ardhur në ndihmë.

Nëse ka ndonjë ofiq, do të tregohet më dashamirës me vartësit e tij. Nëse ndodhet vetë nën pushtetin e të tjerëve, ka për t'u bindur me gatishmëri dhe do të punojë më me kujdes. Nëse ai vetë ndodhet në nevojë, do të pranojë me mirënjohje edhe ndihmën më të vogël dhe do të lutet me mirënjohje më shumë se herët e tjera për bamirësinë e tij. Dhe të gjithë sa marrin pjesë në Liturgjinë Hyjnore, ikin të transformuar, më të paqtë, më të zbutur në marrëdhëniet me të tjerët, më zemërmirë, më të ëmbël.

Prandaj, ai që do të përparojë dhe të bëhet më i mirë, duhet të marrë pjesë sa më shpesh që mundet në Liturgjinë Hyjnore dhe madje të marrë pjesë me kujdes dhe të ketë përjetim. Liturgjia e ndërton dhe e formon të krishterin përduror dhe në mënyrë mistike. Dhe nëse shoqëria jonë nuk është shpërbërë tërësisht dhe nuk është shkretuar, nëse njerëzit nuk ndahen nga urrejtja vdekatare dhe e pashuar, shkak i fshehtë i tërë këtyre është Liturgjia Hyjnore, që i kujton secilit nga ne dashurinë e shenjtë dhe qiellore për vëllezërit tanë... Ndikimi i Liturgjisë Hyjnore mund të jetë shumë i madh nëse secili që



merr pjesë, i vë vetes detyrë që të zbatojë ato që dëgjon aty. Të gjithë i mëson në mënyrë të barabartë, në të gjitha shtresat shoqërore dhe në të gjitha klasat vepron njësoj, nga i pari deri tek më i fundit, duke u thënë të gjithëve të njëjtën gjë dhe me të njëjtën gjuhë, duke i mësuar pra dashurinë, “që është lidhja e përsosmërisë” (Kol. 3:14), shtysa e fshehtë që vë në lëvizje mbarë gjithësinë.

Por nëse Liturgjia Hyjnore vepron aq fort ndër ata që marrin pjesë tek ajo, shumë më tepër ndikon ajo tek ai që e kryen, te prifti. Kjo gjë, nëse e kryen me shpresëtarë, me frikë Perëndie, besim dhe dashuri pastrohet si enët e kishës dhe ngelet i panjollë gjatë gjithë ditës. Te prifti në plotësimin e shërbësës së tij baritore - brenda familjes së tij ose brenda ambientit shoqëror ku ndodhet dhe veçanërisht me famullitarët e tij, të cilët edhe këta janë familja e tij - vetë Zoti Shpëtimtar ikonizohet në pamjen e tij. Kështu, në të gjitha veprat e Tij, Krishti është Ai që i kryen ato. Në të gjitha fjalët është Krishti Ai që i flet. Dhe kur prifti përpigjet të pajtojë armiqtë, kur përpigjet të frymëzojë tek ai që është më i fortë dhembshurinë për të dobëtin; kur vuan që të zbusë zemërashprin, kur ngushëllon të hidhëruarin, kur i nxit durimin atij që tiranizohet, fjalët e tij kanë për të vepruar si vaj shërues dhe do të jenë në çdo rast fjalë paqeje dhe dashurie.

Dhjak Anastas Bendo

Statistika për jetën e Kishës Orthodhokse të Rusisë


Në mbledhjen e episkopit rus, që u mbajt më 2 shkurt, në kishën katedrale të Krishtit Shpëtimtar, në Moskë, Patriarku Kirill bëri publike disa statistika për gjendjen aktuale të Kishës Orthodhokse Ruse.

Sot, Kisha ka 160 dioqeza, me 207 episkopë, 28434 priftërinj dhe 2626 dhjakonë.

Për besimtarët funksionojnë 30142 enori dhe 788 manastire, nga të cilat 386 për burra dhe 402 për gra.

Në vitin 2009 u krijuan 2 dioqeza të reja, ajo e Kalininogradit dhe ajo e Buriatit, dhe u dorëzuan 7 episkopë.

Në vitin e parë si Patriark, Fortlumturia e Tij Kirilli I vizitoi 24 dioqeza. Vizita e parë e tij në një kishë orthodhokse motër ishte ajo në Patriarkanën e Konstantinopojës.



Egjipt

Përfundon restaurimi i manastirit shumë të njohur të Shën Andonit



Këshilli suprem i Antikiteteve të Egjiptit plotësoi një restaurim, që zgjati 8 vjet dhe kushtoi rreth 10 milion euro, të manastirit më të vjetër në botë, i themeluar nga dishepujt e Shën Andonit (251-356).

Njëkohësisht, ky restaurim risolli përsëri në vëmendjen e mediave ndërkombëtare gjendjen e vështirë të të krishterëve në atë vend, ku edhe për të bërë një restaurim objekti fetar, duhet marrë më parë aprovimi i qeverisë.

Në këtë vend të izoluar, në malet e shkretëtirës që shtrihet përgjatë brigjeve të Detit të Kuq, Shën Andoni u vendos në fund të shek. III, në një shpellë që kishte afër vetëm një burim të vogël dhe disa palma.

Pas fjetjes së tij, në vitin 356, pasuesit krijuan manastirin e parë të krishterë, në vendin ku ndodhet vendvarrimi i shenjtit.

Punimet rinovuan muret mbrojtëse që rrethojnë manastirin, disa godina dhe dy kishat kryesore, atë të Apostujve, të shek. XV dhe kishën e Shën Andonit, të shek. IV.

Ky manastir i njohur në mbarë botën pret rreth 1 milion pelegrinë çdo vit.

Të krishterët në Egjipt janë rreth 10 për qind e popullsisë (79 milion), por vuajnë diskriminime të shumta dhe nuk janë të përfaqësuar si duhet në parlament, forcat e sigurisë, edukim etj. Gjithashtu, herë pas here ata janë pre e sulmeve të armatosura të fanatikëve myslimanë me lloj-lloj pretekstesh të sajua.

Me www.orthodoxalbania.org

do të gjeni në internet Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë

Kisha jonë Orthodhokse me faqen e saj zyrtare përpigjet të përcjellë mesazhin dhe informacionin e saj edhe në internet.

Ajo i nje vizitorët e saj me:

- besimin e krishterë orthodhoks,
- organizimin dhe veprimtarinë e strukturave institucionale,
- lajmet më të fundit,
- arsimin, edukimin dhe shërbimin social e kulturor që ofron në shoqëri,
- ndërtimin dhe restaurimin e kishave dhe manastireve,
- botimet kishtare etj.

Teksti këtu ndërthuret me fotografi, mesazh zanor, muzikor e filmik.

Këtë informacion do ta gjeni në tri gjuhë: shqip, anglisht e greqisht.



Shihemi, lexohemi e dëgjohemi në moment dhe kudo në të gjithë globin me www.orthodoxalbania.org

Kalendari

i Liturgjive Hyjnore, MARS 2010

3 E Mërkurë † Dësh. Eftropi, Kleoniku, Va silisku. Hierod. Theo-dhoriti.

5 E Premte † Oshd. Kononi. Konon kopshtari. Dësh. Onisi. *(III e Akathistit)*

6 E Shtunë † Të 42 dësh. e Amorit (Aeti, Melisini, Krateri, Kalisti etj.).

7 E DIEL † **III KRESHMËS (Falja e Kryqit)**. Hierod. Efremi, Vasileu. **9 E Martë** † 40 dësh. e Sebastisë (Viviani, Valeri etj.). Qesari mjek. *(Hahet vaj e verë.)*

10 E Mërkurë † Dësh. Kodrati. Anastasia patricia. Dësh. Markiani. **12 E Premte** † Omol. Theofani. Grigor Dialogu i Romës. *(IV e Akathistit)*

13 E Shtunë † Transf. i lips. të Niqiforit të Kon/pojës. Mario i Sebastisë.

14 E DIEL † **IV KRESHMËS (Joani i Shkallës)**. Osh. Benedikti.

17 E Mërkurë † Osh. Aleksi, njeriu i Perëndisë. Patriku, ndriç. i Irlandës.

19 E Premte † Dësh. Krisanthi, Daria, Klaudi, Ilaria. *(Akathisti i plotë)*

20 E Shtunë † Osh. vvarë në Manastirin e Sh. Savës. Dësh. Rodiani.

21 E DIEL † **V KRESHMËS (Maria e Egjiptit)**. Jakovi i Katanas.

24 E Mërkurë † Hierod. Artemoni. Hierod. i ri Partheni i Kon/pojës.

25 E ENJTE † **Ungjillëzimi i Hyjlindësës (Vangjelizmoi)**. *(Hahet vaj, verë e peshk.)*

26 E Premte † Mbledhja e Kr/engjellit Gavriil. 26 dësh. e Gotisë. *(Hahet vaj e verë.)*

27 E Shtunë † Ngjallja e L Lazarit. Dëshg. Matrona. Dësh. Filiti, Lidia e bijtë.

28 E Diel † **E DAFINAVE, Hyrja e Krishtit në Jerusalem**. *(Shërbesa e dhëndrit) (Hahet vaj, verë e peshk.)*

29 E Hënë † **E MADHE**. Josifi i Dhiatës së Vjetër. *(Shërbesa e dhëndrit)*

30 E Martë † **E MADHE**. (Paravolia e 10 virgjërshave.) *(Shërbesa e dhëndrit)*

31 E Mërkurë † **E MADHE**. Lyerja e këmbëve të Zotit Krisht. *(Bëhet Efqeli.)*


Doli në qarkullim numri i ri i revistës “Kërkim”

Më 4 nëntor, Kryepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë, Fortlumturia e Tij prof. dr. Anastasi, mbushi 80 vjeç.

Një ditë kjo e shënuar jo vetëm për besimtarët orthodhoksë të Shqipërisë, por dhe për të gjithë ata, të krishterë e jo të krishterë, që e kanë njohur dhe vlerësuar për kontributin e jashtëzakonshëm të një jete përkushtuar përhapjes së besimit dhe paqes.

Redaksia e revistës “Kërkim”, këtë numër ia ka kushtuar këtij evenimenti, ku personalitete të spikatura intelektuale kanë shprehur refleksionet e tyre për pjesë të veçanta të këtij kontributi sa unik aq dhe Perëndindriçuar.

Të shkruash për prof. dr. Anastasin është e vështirë, sepse veprimtaria e tij është aq e gjerë, sa do duheshin disa numra për ta mbuluar disi tërë spektrin e tij. Ky numër i revistës është një shprehje e thjeshtë mirënjohjeje. Jemi përpjekur që lexuesit t'i japim një informacion për kontributin e tij në fusha të ndryshme, kuadër që plotësohet nga një biografi e hollësishme, si dhe nga botimet e Fortlumturisë së Tij.



Vazhdojnë projektet që synojnë përmirësimin e shëndetit të vajzave dhe grave në zonat rurale

Në vazhdën e projekteve që synojnë përmirësimin e statusit të grave në Shqipëri, gjatë muajit tetor 2009 Zyra Diakonia Agapes filloi realizimin e projektit “Promovimi i Testimit Vullnetar, Konfidencial dhe me Këshillim për HIV”. Zona e përfshirë në këtë projekt janë fshatrat e Elbasanit, Gramshit dhe Librazhdit.

Me qëllimin të rrisë ndërgjegjësimin e komunitetit për HIV/

SIDA-n dhe rëndësinë e testimit dhe këshillimit vullnetar, ky projekt është i përqendruar më shumë te gratë dhe vajzat e kësaj zone.

Një grup i përbërë nga mjekë, punonjës socialë dhe këshillues udhëton në fshatrat e synuar dhe takohet me gratë dhe vajzat e interesuara. Takimet, të organizuara në bashkëpunim me personelin shëndetësor të zonave, shërbejnë për të informuar pjesëmarrëset rreth HIV/

SIDA-s, ecurisë së kësaj epidemie dhe rëndësisë së testimit vullnetar shoqëruar me këshillimin. Për të interesuarit për testim, ofrohen seanca këshillimi personale dhe konfidenciale dhe më pas testimi i shpejtë i HIV-it, përgjigjja e të cilit është gjithashtu konfidenciale.

Deri më sot 350 gra kanë marrë pjesë në takime si dhe 200 prej tyre janë testuar vullnetarisht për HIV.

Pjesëmarrëseve në takime u

shpërndahen broshurat e përgatitura me informacion të nevojshëm rreth çështjes së HIV/SIDA-s.

Ky aktivitet shoqërohet edhe me ndërgjegjësimin e komunitetit që bëhet me anë të shpërndarjeve të fletëve informuese dhe postereve në zonë.

Ky projekt financohet nga Fondation PH - Suisse - Partnerships in Health dhe do të vazhdojë deri në fund të muajit mars 2010.

Kontribut nga besimtarët orthodhoksë për zonat e përmbytura

Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë iu përgjigj që në çastet e para nevojave të zonave që u goditën nga përmbytjet. Vetë Fortlumturia e Tij, Kryepiskopi Anastas, u bëri thirrje besimtarëve të dhuronin sa të kishin mundësi, duke dhënë shembullin e tij personal.

Ditën e diel, pas Liturgjisë Hyjnore, në kishat kryesore orthodhokse iu bë thirrje besimtarëve të moshave dhe shtresave të ndryshme që të solidarizoheshin me vëllezërit e tyre të goditur nga kjo fatkeqësi, duke dhënë kontribute personale në para. Kështu u mbledhën 613 520 lekë të rinj, ku vetëm në qytetin e Tiranës u mbledhën rreth 170 mijë lekë.

Në datën 3 shkurt u bë dorëzimi i kësaj ndihme, në llogarinë bankare të hapur për këtë qëllim. Episkopi i Krujës, Hirësia e Tij Andoni, i shoqëruar nga klerikët atë Aleksandër Petani dhe atë Nikolla Petani, u takuan në Bashkinë e Shkodrës me Kryetarin, z. Lorenc Luka, i cili shprehu admirimin e tij për këtë solidaritet të treguar nga besimtarët orthodhoksë, i cili ka një vlerë të madhe.

Kryetari i Bashkisë i njohti ata me gjendjen në këtë zonë. Ai u shpreh se kjo situatë katastrofike kaloi pa dëme në njerëz dhe se të gjithë personat e shpërngulur nga përmbytjet tashmë janë kthyer nëpër ba-



nesat e tyre dhe situata po shkon drejt normalizimit.

Kjo ishte ndihma e dytë e dhuruar prej Kishës Orthodhokse për zonën e

përmbytur të Shkodrës brenda një kohe të shkurtër. Ndihmesa e parë ishte ajo e dhënë që në çastet e para në Shtabin e Emergjencës

së këtij qyteti, me 5 tonë ndihma, të cilat përmbanin ushqime, veshmbathje, shtresa, etj.

Korresp. “Ngjallja”